



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 54/19
Prishtinë, më 13.06.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadergjonaj, Arbërie Nagavci, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Ali Lajçi, Fikrim Damka dhe Enver Hoti.

Munguan: Jelena Bontic, Blerim Kuçi dhe Dardan Molliqaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Ismet Krasniqi-Sekretar-Kuvendi; Istret Azemi-Drejtor për Buxhet dhe Pagesa; Besnik Osmani-Auditor i Përgjithshëm në ZKA; Imri Semetishti- nga ZKA; Afërdita Maliqi-Kryetare e Bordit të RTK-së, Lirim Geci-Anëtar i Bordit- në RTK; Ngadhënjim Kastrati-Drejtor i Përgjithshëm në RTK, Adelina Hyseni-Valla - Menagjere Financave në RTK; Agron Gashi nga RTK; Ilir Shala-Kryeshef Ekzekutiv në KOSTT, Visar Hoxha-Sekretar në KOSTT;

Pjesëmarrës tjerë: Dardane Neziri- Gazetare nga Koha Ditore; Burbuqe Ibishi-Gazetare nga Kosova Press; Xheneta Murtezaj-Gazetare nga KALLXO.com; Nora Kelmendi- Gazetare nga Ekonomia Online; Drita Vitia-Gazetare nga Radio Kosova; Majlinda Jashanica- NGO AKTIV; Aurel Haxhiu-D+; Bleona Ramaj-KDI; Kujtesa Bajrami-Gazetare nga RTV21, Gentiana Kelmendi-Gazetare nga RTK; Blerta Bejtullahu-Zyra e BE-së.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini dhe Dashurije Canolli, Doruntina Pireva-Praktikante, Sofie Tahiri- Praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Lumir Abdixhiku, Kryetari i Komisionit (tutje Kryetari).

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 29.05.2019;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2019;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-100 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
- 5. Shqyrtimi Raportit vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018;**

6. **Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2018;**
7. **Diskutim në lidhje me Kërkesën nr. 590, dt. 16.04.2019 e KOSTT, lidhur me çështjen e pagave;**
8. **Shqyrtimi i Kërkesës nr.00255/19/shs, dt. 11 Mars 2019 së Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e lartësisë së koeficientit dhe të pagës së Drejtorit dhe Zëvendës-Drejtorit të kësaj Agjencie;**
9. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari: Propozoj që të plotësohet rendi i ditës me dy pika shtesë: Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores Buxhetore 2020/0.1 dhe Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 06/L-176 për Hetim Parlamentar dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Kryetari konstatoi se komisioni unanimitisht miratoi rendin e ditës me plotësimin e dy pikave shtesë si pika 4 dhe 5 me radhë. Në vazhdim bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 29.05.2019

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi procesverbalin pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2019

Ismet Krasniqi: Raporti i tre mujorit të parë të vitit 2018, përfshin shpenzimet e realizuara. Për paga dhe mëditje kemi shpenzuar 1 milion e 572 mijë euro, mallra dhe shërbime 226.926 apo 87%, shpenzime komunale 71,159.40 euro 85.4%, subvencione dhe transfere 35,166 apo 95%, ndërsa shpenzime kapitale nuk kemi pasur.

Kryetari: Për çfarë arsye janë shpenzuar subvencionet sepse është një shumë e madhe?

Ismet Krasniqi: Theksoi se në raport janë të dhënat shumat dhe përfituesit e subvencioneve, ndërsa dokumentacionin më detal mund ta përgatisim për Komisionin pas mbledhjes.

Enver Hoti: Duke marrë parasysh anën financiare të Kuvendit dhe investimeve që nuk ka pasur asnjëherë. Pyetja ime është a pritet që investimet kapitale të realizohen në bazë të planifikimit buxhetor të Kuvendit?

Ismet Krasniqi: Zakonisht fillohet me procedura të inicimit, buxheti duhet t'i propozojë çdo procesi financiar të planifikimit të paraparë nga Administrata dhe Kuvendi. Kemi pritur miratimin e buxhetit të Kosovës i cili ka ndodhur me vonesë, Si administratë në pajtim edhe me planin e veprimit për vitin 2019 i kemi kryer të gjitha aktivitetet por, ato do të varen edhe nga faktorët e jashtëm si operatorët ekonomik dhe procedurave të cilat në raste të ankesave shkojnë tek Organi Shqyrtues i Prokurorit.

Kryetari: Dua të theksoj se edhe këtë tremujor këshilltarët e Kryetarit të Kuvendit kanë shpenzuar në udhëtime jashtë vendit, akomodime tjera proporcionalisht gati sa 40% e deputetëve të Kuvendit. Unë nuk e kuptoj pse Kryetari duhet të udhëtojë me kaq shumë këshilltarë. Vetëm në udhëtimin një javor në

SHBA, z. Veseli me tre këshilltarë ka shpenzuar 21 mijë euro. Një dhomë hoteli është paguar prej 600 dollarë. Pse duhet Kryetari të udhëtojë me kaq shumë këshilltar jashtë vendit. Jemi vend i varfër, ne shkojmë për të kërkuar ndihmë jashtë vendit, ndërsa shpenzojmë shuma të mëdha në këto vizita nga buxheti i varfër.

Arbërie Nagavci: Përveç vërejtjeve që ngriti kryetari i komisionit, shihet se shpenzimi i buxhetit bëhet në formën më banale. Me gjithë respektin për formën se si i dërgoni, ne kemi kërkuar edhe herën e kaluar që për çdo shpenzim të jenë edhe vendimet për të parë arsyetimet e vizitave. Poashtu në detale kemi kërkuar edhe të dhënat për subvencionet dhe drekat zyrtare. Përveç shpenzimeve të udhëtimit edhe shpenzime tjera vazhdojnë të bëhen të lartë. Janë rreth 30,000 euro të shpenzuara për drekat zyrtare, pa arsyetime dhe shumica e drekave apo mbi 20 dreka zyrtare janë të shtruara nga Kryetari i Kuvendit. Për arsye të mënyrës së shpenzimeve të buxhetit që janë shpenzime të luksit, nuk do të votojmë këtë raport.

Mërgim Lushtaku: Si shtet i ri kemi nevojë për diplomaci dhe lobim ndërkombëtar. Këto aktivitete i zhvillon Ministria e Punëve të Jashtme, Presidenca dhe Kryeministri. Jemi në fazën më të ndjeshme dhe çdo institucioni i duhet një lobim ndërkombëtar. Mendojë se nuk duhet të tërheqim vëmendjen vetëm tek shpenzimet, pasi që në kushtet tona po bëjmë më të mirën. Sigurisht edhe shpenzimet kanë rëndësi, por vëmendja më e madhe duhet të jetë në arritjen e qëllimeve më të mëdha në përfaqësimin e vendit dhe njohjen nga jashtë.

Ali Lajçi: Realisht ne kemi parë raportin e Kuvendit për lobime ndërkombëtare. Jemi në fazën më të ndryshme dhe në këtë drejtim pas diasporës, që të kemi mbështetje të mirë, kemi nevojë të përfaqësohemi edhe më denjësisht. Gjithmonë ka mundësi të bëhet më mirë dhe përveç Kuvendit duhet edhe deputetët e anëtarët e komisionit të kenë paraqitje më të mirë të institucioneve. Lidhur me shpenzimet ka punuar edhe stafi i cili merr pjesë në organizime tjera jashtë vendit. Pyetja ime lidhur me vizitat e realizuar nga stafi politik është se në bazë të çfarë procedurave janë realizuar vizitat dhe cilat kanë qenë arsyet?

Ismet Krasniqi: Sqaroi se çdo shpenzim mbështetet me vendime të Kryesisë së Kuvendit.

Safete Hadergjonaj: Zakonisht kur vinë raportet vëmendja përqendrohet tek stafi politik, sikur e kemi bërë retorikë një punë të tillë. Megjithatë Kuvendi i Kosovës duhet promovojë punën, angazhimin dhe fuqizimin e shtetit. Prandaj edhe këto udhëtime me karakter të tillë do të shihen me pozitivitet. Unë në raport shoh se në këto udhëtime zyrtare janë të gjithë deputetët edhe nga opozita. Te stafi politik shoh se për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 14,404,78 euro . Paga dhe mëditje 201 mijë e 834, 74 euro, për akomodim 7,946 euro, për udhëtime zyrtare tjera 1,340,58 euro dhe disa shpenzime kontraktuese për telefon 1 mijë e 20 euro. Në këtë raport nuk është një shifër prej 21 mijë eurosh, andaj duhet të jemi real dhe t'i lexojmë numrat siç shihen dhe prezantuar në raport. Unë jam pro kufizimit të shpenzimeve sidomos jashtë vendit dhe vizitat zyrtare që nuk janë të karakterit shtetëror të mos shkojnë por deputetët të marrin pjesë në seanca plenare në Kuvend.

Ismet Krasniqi: Sa i përket përpjekjeve të kufizimeve të shpenzimeve, në rast të udhëtimit zyrtar kur Kuvendi mbulon 100% shpenzimet nuk lejohet shkuarja e më shumë se një anëtar i grupeve parlamentare në udhëtim.

Kryetari: Sa i përket vizitës së Kryetarit të Kuvendit në SHBA, për akomodimin e këshilltarëve të Kryetarit janë shpenzuar 6,000 euro, akomodimi i z.Veseli 3,200 euro, ndërsa shpenzime tjera 4,600 euro. Unë e kuptoj se Kryetari duhet të realizojë vizita, por kërkesa është të shkohet më pak staf apo në shoqërim të deputetëve. Komisioni ynë ka bërë vetëm një vizitë jashtë në dy vjet mandat, dhe atë në

Maqedoni. Nuk është normale me bë shpenzime luksi, ndërsa në anën tjetër me kërkuar mbështetje dhe ndihmë nga jashtë.

Safete Hadergjonaj: Unë nuk e thash shifrën përmendësh. Të gjitha shpenzimet që janë gjithsej 21 mijë euro janë të Kryetarit dhe për të gjithë deputetëve. Unë lexoj se për stafin politik, janë 14 mijë euro shpenzime.

Kryetari: Po harroni t'i shtoni edhe shpenzimet e z.Veseli sepse ai nuk është staf politik por deputet dhe në emër të tij janë edhe 4,600 euro tjera tek faqja e deputetëve. Unë këtë raport dua t'ua lë mediave për verifikim.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të rezultatit të votimit, Kryetari konstatoi se Komisioni me 4 vota Për, 4 vota Kundër dhe asnjë votë Abstenim, nxori këtë

R e k o m a n d i m

Komisioni nuk miratoi Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për tremujorin e parë të vitit 2019.

4. Shqyrtimi i Kërkesave Buxhetore të Kuvendit të Kosovës në bazë të Qarkores Buxhetore 2020/01

Ismet Krasniqi: Theksoi se kërkesat buxhetore për vitin 2020-2022 janë të ngjashme me ato të parapara në KASH-in e Kuvendit, me përjashtim që investimet kapitale të jenë në shqyrtim të buxhetit prej 200 mijë euro dhe nevoja për shtimin e buxhetit për Komisionin për Ndihmë Shtetërore.

Kryetari: Me kërkesën që edhe buxhetin për Komisionin e Ndihmës Shtetërore ta fusim të shpenzimet e kërkesave buxhetore në bazë të Qarkores së parë Buxhetore, propozojë ti rekomandojmë Kryesisë së Kuvendit ti miratojë kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2020-2022 dhe Kryesia t'i rekomandojë Ministrisë së Financave, që të njëjtat kërkesa, ti përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2020-2022.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

Të miratohen kërkesat buxhetore të Kuvendit të Kosovës për vitin 2020-2022, sipas dokumentit të bashkangjitur këtij rekomandimi dhe Kryesia t'i rekomandojë Ministrisë së Financave, që të njëjtat kërkesa, ti përfshijë në linjat buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2020-2022.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 06/L-176 për Hetim Parlamentar dhe Amendamenteve të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari: Theksoi se në bazë të Deklaratës së Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamentet e propozuara nga komisioni funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 06L-075 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06L-176 për Hetim Parlamentar dhe amendamenteve e propozuara nga Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-100 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetari: Theksoi se në bazë të Deklaratës së Ministrisë së Financave, Projektligji nuk përmban implikime buxhetore shtesë. Po ashtu as amendamente të propozuara nga komisioni funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të rezultatit të votimit, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 06/L-100 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe amendament etet e propozuara nga Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor,. nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018

Kryetari: I'a kalojë fjalën auditorit të përgjithshëm që të prezantojë dhe arsyetojë raportin financiar të ZKA-së për vitin 2018.

Besnik Osmani: Sa i përket planprogramit për vitin e kaluar, financimi i ZKA-së bëhet nga buxheti por kemi edhe të hyra të donatorëve, një shumë të vogël të hyrave vetanake të cilat derdhen në buxhetin e Kosovës. Numri i auditimeve që kemi kryer në vitin 2018 është 122 për dallim në 2017 që janë 108 dhe 2016 që janë 98 me vet faktin se është rritur numri i auditimeve janë rritur edhe shpenzimet.

Buxheti final ka qenë 2 milionë e 700 mijë, ndërsa niveli total i shpenzimeve 98.3%. Sa i përket strukturës së buxhetit për paga dhe mëditje përfshihet shifra më e lartë e shpenzimeve rreth 74% në totalin e buxheti dhe kemi shpenzuar 2,002,696 apo 100%. Sa i përket anës mallrave dhe shërbimeve ato marrin pjesë 23% në buxhetin total dhe kemi shpenzuar 612,215 apo 94% dhe pjesa më e madhe shkon për qiranë e objektit 28%. Ndikim tjetër tek kjo kategori ka puna jonë në terren dhe për udhëtime zyrtare. Ne kemi pasur tejkalime tek disa nënkategori të mallrave dhe shërbimeve, sepse vitin e kaluar kemi ndërruar objektin që është parë si kosto shtesë dhe shpenzimet e dyta për shkak të vizitave me punë në terren të auditorëve gjatë kryerjes së auditimeve. Shpenzime komunale janë realizuar 84%, ndërsa investimeve kapitale janë realizuar 50,773 euro 94%. Subvencione dhe transfere nuk kemi pasur.

Nga grandet e pranuar nga Banka Botërore janë realizuar 164 mijë euro për vitin 2017-2019, që përfshihet edhe viti që po e raportojmë. Në vitin 2018 kemi shpenzuar 18 mijë e 362 euro nga fondi për auditimin e zyrës tonë që është bërë nga kompania e caktuar prej Kuvendit të Kosovës. Të gjitha veprimet tona kanë qenë në pajtim me kornizën ligjore.

Ali Lajçi: Në raportimit tjera, kemi vërejtur shpenzime për qira në nivel vendi nga institucionet janë , në shumë prej 8 milionë. Ne kemi kërkuar një listë të objekteve shtetërore për të parë hapësirat që janë nën menaxhimin e Qeverisë në mënyrë që të vendosen institucionet pasiqë shpenzimet për qira po janë mjaftë të larta.

Naser Osmani: Sa i përket shpenzimeve për qiranë për këtë Zyrë, ne kemi diskutuar edhe vitin e kaluar dhe kemi theksuar se ky institucione kushtetues ka nevojë për një objekt që është edhe reprezentativë. Unë kisha pasur dëshirë të dijë mendimin e auditorit gjeneral, në diskutime që ka zhvilluar me institucionet përgjegjëse sa çfarë është bërë në zgjidhjen e objektit të këtij institucioni?

Besnik Osmani: Ne kemi bërë të gjitha përpjekjet që të kemi një objekt i cili është në pronësi publike, besoj se kemi biseduar me të gjitha autoritetet përkatëse në mënyra të veçantë. Fatkeqësisht arsyetimi është që nuk ka hapësira të mjaftueshme. Jemi vonuar sepse tek objekti me qera kemi pasur një kërkesë mandatore para se të hymë në kontakt me çdo pronar, që të kemi të drejtën e shkëputjes së kontratës nëqoftëse, Qeveria na siguron objekt. Komuna e Prishtinës na ka ofruar një vend në ish-shkollën e vjetër ekonomike që është dashur të rinovohet nga fillimi. Këtë objekt nuk kemi mundur ta shfrytëzojmë edhe për shkak të lokacionit apo vendndodhjes së tij. Ky institucion paguan qera nga themelimi dhe paguhen rreth 4 milionë euro prej të cilave do ishin ndërtuar së bashku tri objekte.

Imri Semetishti: Shuma e qirasë mujore që paguajmë si ZKA është 13 mijë e 500 euro në hapësirë të dy objekteve dhe oborrit që shfrytëzojmë.

Kryetari: Kemi kërkuar nga ju një auditim të performancës për RTK-në gjë që e keni bërë dhe nga informatat që kam është ende draft. Në kuadër të kësaj teme, lidhur me auditimin e RTK-së. Ligji i RTK-së thotë që RTK angazhon një kompani private të auditimit, megjithatë kornizës e përgjithshme ligjore mundëson që ZKA mund të bëjë auditimin e rregullsisë apo të pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike, dhe rrjedhimisht edhe të RTK-së. Cili është mendimi juaj si auditor për këtë çështje?

Besnik Osmani: Ne kemi marrë kërkesë nga Kuvendi për auditim të performancës dhe kemi filluar menjëherë me RTK-në duke përgatitur një draft-raport. Pas kontakteve që kemi zhvilluar me RTK, nga drejtori i mëparshëm kemi marrë shqetësimin se për arsye ligjore se auditori i përgjithshëm nuk mund të bëjë auditimin, por do bëhet nga një kompani private. Ia kam sqaruar drejtorit, kemi mbërritur tek draft raporti, kemi marrë shkresë nga drejtori i ri i RTK-së i cili ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim por poashtu ka kërkuar që të sqarohet baza ligjore për një auditim të tillë. Kushtetuta e njeh mundësinë e auditimit nga ZKA të të gjitha institucioneve që marrin fonde publike pa përjashtime. Për të larguar çdo dyshim ne kemi kërkuar një mendim ligjor nga Kuvendi, ia kemi drejtuar kërkesën me shkrim Kryetarit të Kuvendit dhe jam në pritje të përgjigjes dhe varësisht nga mendimi, do merren veprime konkrete për auditimin e RTK-së dhe auditime tjera të veçanta.

Kryetari: Unë propozoj që pas shqyrtimit të raportit financiar të RTK-së të diskutojmë si komision për rekomandimet që të dërgojmë ftesë ZKA-së për auditim të RTK-së dhe nëqoftëse ka rezistencë të veprojmë me procedurë të shpejtë ligjore. Nuk ka logjikë që RTK-ja të marrë 13 milionë euro dhe të mos pranojë auditim, vetëm nëse ka diçka me fshehtë.

Enver Hoti: A ka ndërmarrje tjera publike që nuk kanë bërë asnjëherë auditim dhe keni hasur ne rezistencë të tillë nga ndonjë ndërmarrje e tillë?

Besnik Osmani: Në përgjigjen e parafolësit, sqaroi se në vitin 2016 kur kam ardhur nuk ka pasur asnjë ndërmarrje publike të audituar, tani numri ka arritur në 15. Nëse kemi përkrahjen e Kuvendit atëherë do

mundemi ti mbulojmë të gjitha ndërmarrjet publike, nuk kemi pasur asnjë rezistencë dhe në raste konkrete ligji parashikon që unë të thërras mekanizma detyrues për të mundësuar një auditim të tillë.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të rezultatit të votimit, Kryetari konstatoi se Komisioni me 6 vota Për, një votë Abstenim dhe Asnjë votë Kundër, nxori këtë

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018.

8. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2018

Kryetari: I'a kalojë fjalën Kryetares së Bordit të RTK-së që të prezantojë dhe arsyetojë raportin financiar të RTK-së për vitin 2018.

Afërdita Maliqi: RTK-ja brenda afatit ligjor ka dorëzuar raportin vjetor të punës së bashku me raportin e auditimit për 2018. Raporti mbledh të gjitha aktivitetet, poashtu RTK ka organizuar takim informues me publikun për sfidat një vjeçare. Ka mbyllur vitin 2018 RTK-ja me 819 të punësuar të rregullt dhe 213 të punësuar me kontratë me shërbime nën 4 kanale televizive, 2 kanale të radios dhe mediave online. Në këtë raport hynë shpenzimet e të hyrave për RTK 1, 2, 3, 4, Radio Kosova, mediat online. Të hyrat e RTK-së përbëjnë 85%, nga marketingu kanë gjeneruar 12% dhe të tjera 3%.

RTK për periudhën raportuese ka paraparë të hyra me shumë prej 13 milionë e 400 mijë, ndërsa ka realizuar të hyra në shumë prej 13 milionë e 342 mijë e 903 euro. Në fund të vitit 2018 dallimi në mes të hyrave dhe shpenzimeve është 57,153 euro. Sikur në vitet paraprake edhe gjatë 2018 shpenzimet i kishte më të ulta se të hyrat. Aktiviteti financiar i është nënshtruar auditimit të rregullt financiar dhe është vlerësuar me opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes. Baza për theksim kishte të bëjë me çështjen e aseteve të pakufizuara dhe aplikimi korigjimit të vlerës së tyre për ndonjë dëmtim të mundshëm. RTK poashtu në vitin 2016 ka rifunksionalizuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm e cila gjatë vitit 2018 ka kryer 4 auditime, 1 raport të mbikëqyrjes së zbatimit të rekomandimeve të të dhënave 2017, plani strategjik i auditimit dhe ai vjetor i auditimit.

Në periudhën raportuese RTK ka insistuar në rritjen e programit të vet, me përmbajtjen tonë RTK ka arritur të jetë e pranueshme në të gjitha kategoritë shoqërore e komunitete. Ka arritur në përmissimin e teknologjisë, digjitalizimin e brendshëm dhe qasjen e shikuesve në përmbajtjen tonë. Çështja preokupuese është borxhi i bartur ndër vite që po shkakton problem në realizimin e veprimtarisë së përditshme. Problem tjetër është edhe çështja e objektit të RTK-së, pavarësisht se Ministria e Administratës Publike ka ndarë mjete, nuk ka lëvizje të ndërtimit të objektit.

Arbërie Nagavci: Propozojë që raporti vjetor financiar i RTK-së për vitin 2018 të mos votohet sot, por në mënyrë të shpejtë të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit që Kuvendi të kërkojë nga ZKA të bëjë një auditim të pasqyrave financiare të RTK-së dhe besoj që mëpastaj do kemi një pasqyrë më të qartë të shpenzimeve pas pranimi të raportit të auditimit.

Kryetari: Nga auditori kuptuam se ju keni refuzuar ose kontestuar të drejtën e auditorit të përgjithshëm për auditimin e RTK-së?

Adelina Hyseni-Valla: Theksoi se vitin e kaluar ne nuk e kemi refuzuar kërkesën e auditimit nga auditori i përgjithshëm. Auditorët kanë ardhur dhe i kanë kryer veprimet e tyre, e dorëzuan një draft raport të performancës për të cilin kemi diskutuar dhe kemi dhënë komentet tona. Mirëpo ka mbetur tash të ipet një raport final dhe atëherë mund të bisedojmë.

Kryetari: Me sa e shoh nuk e keni problem që auditori të vijë e të auditoj edhe pasqyrat financiare, pasi sot ne e morëm vesh më ndryshe nga auditori.

Afërdita Maliqi: Për kërkesën për auditim nga auditori i përgjithshëm jemi njoftuar nga menaxhmenti i kaluar i cili me auditorin kanë diskutuar çështjen e ligjshmërisë e auditimit të RTK-së.

Ngadhënjim Kastrati: Letrën e auditorit e kemi trajtuar me sektorë, jemi takuar me anëtarët dhe kemi biseduar për çështjet. Mirëpo nuk qëndron ajo se ne nuk kemi pranuar apo refuzuar auditorët, i kemi dërguar komentet tona për të gjitha çështjet nga ata që e kanë ngritur.

Kryetari: Në fakt puna e auditorit në auditimin e RTK-së është pezulluar sipas auditorit deri në qartësimin e çështjes ligjore, ne do i kërkojmë edhe njëherë auditorit të vazhdojë punën sepse ka bazë ligjore për një auditim të tillë.

Sa i përket raportit financiar që keni dërguar në Kuvend, është e vështirë të thuhet se keni shpenzuar mëditjet qindpërqind siç i keni prezantuar ose nuk keni bërë planifikim në fillim të viti dhe i keni përshtatur shpenzimet me planifikimin. E njëjta gjë është edhe tek shpenzimet qindpërqind për naftë.

Sa i përket të punësuarve, më intereson ta di në bazë të krahasimit të raportit të auditorit janë 54 të punësuar më shumë se sa keni prezantuar në raportin financiar. Pse kjo mospërputhje e të punësuarve? Çështja e dytë është për korrespondent të jashtëm, ju keni 238 mijë euro të shpenzuar për korrespondent të jashtëm dhe shpenzimet e udhëtimit për gazetarë që i përcjellin delegacionet e keni shpenzuar qindpërqind buxhetin e planifikuar. Nëse keni korrespondentë të jashtëm në disa qendra dhe paguhen për punën e tyre, pse duhet të dërgoni ekipe shtesë të gazetarëve me i përcjellë delegacionet në këto vende ku vizita mund të mbulohet nga korrespondenti?

Më intereson të di tek çështjet e kontraktimit të emisioneve të jashtme, e di që keni thënë se ligji ju obligon të kontraktohen emisione të tilla prej 20%. Por, më intereson të di se p.sh Emisioni Pa Rrotulla a është me ligj patjetër Milaim Zekës ti ipen 44,000 euro në vit? Apo emisioni Kuizi 1, 2, 3 fillo 10,000 euro? Nëse keni 800 punëtorë pse duhet t'i ipen 44 mijë euro për një emision të jashtëm dhe mos ta realizoni një emision të tillë nga punëtorët e brendshëm? Sa është shuma e borxhit të akumuluar? Edhe pyetja e fundit shpenzime përmbarimore keni 30 mijë euro 200% më të larta se planifikimi. Çfarë janë më saktësisht këto shpenzime?

Arbërie Nagavci: Unë kisha dashur me shtrë çështjen e shpenzimeve operationale të bordit, prej dikund 10 mijë euro që kanë qenë për 2017, kemi 19 milion e 320 mijë euro të shpenzuar në vitin 2018. Pse janë rritur këto shpenzime të bordit?

Enver Hoti: Tek numri i të punësuarve dhe nëse flasim për atë numër shohim se është rritur sipas fazave, shërbime komunale keni përfshirë edhe kategori tjera me shpenzim qindpërqind, kërkoj një zbrëthim më të qartë të këtyre shpenzimeve. Unë mendoj se nuk duhet votuar raportin sot, deri sa të pranojmë raportin e auditimit nga auditori i jashtëm.

Ali Lajçi: Borxhet e mbetura në vitet e kaluara kur keni bërë planifikime buxhetore, kishte qenë mirë me u shlyer ato borxhe, pastaj me mendu për shpenzime tjera.

Adelina Hyseni - Valla: Sa i përket pagave dhe mëditjeve nuk ka pasur ndonjë tejkalim të buxhetit, në numrin e stafit ne kemi sjellur dy raporte. Në raportin e Kuvendit të cilin e kemi paraqitur kemi cekur se stafi i rregullt është 807 punëtorë, 213 të angazhuar dhe 6 të menaxhmentit dhe 7 të bordit.

Kryetari: Një pyetje drejtorit: a mendon se duhet të shtohet stafi i RTK-së?

Ngadhënjim Kastrati: Theksoi se të punësuarve që iu ka përfunduar kontrata nuk iu ka vazhduar dhe atyre që janë bashkëpunëtorë të jashtëm. Ne do të punësojmë vetëm ato pozita që janë të domosdoshëm.

Arbërie Nagavci: Sipas jush janë 49 të punësuar në vitin e fundit duke e ditur si janë procedurat për shpalljen e konkurseve nëpër institucione publike ku nevojitet të ketë planifikim paraprak, poashtu aprovim nga ministritë e linjës, a janë respektuar këto procedura në institucionin tuaj me rastin e punësimeve? A i keni pasur të planifikuara këto vende paraprakisht?

Adelina Hyseni - Valla: Siç e ceka në fillim nuk ka pasur tejkalim në paga dhe mëditje, në plan vjetor kanë qenë të planifikuara pozitat e punësuar.

Kryetari: Teknikisht ky është fenomeni i ndërmarrjeve publike që po ndodh në Kosovë. Një ndërmarrje publike që është zhytur në probleme financiare, e zhytur në borxh, vazhdon të rrisë numrin e punëtorëve. Ku kjo ka ndodhë në RTK. Është paradoks operimi. Nuk mund të kesh probleme financiare edhe me rrit numrin e punëtorëve!

Ngadhënjim Kastrati: Sa i përket korrespondentëve, është e vërtetë që në Bruksel, Berlin kemi korrespondentë, por sigurisht që edhe shfrytëzohen për përgatitjen e kronikave sidomos në Berlin, por Gjermania është e madhe, ndoshta i bjen më afër me shku prej Kosovës në Minhen, por jo gjithmonë gazetarët e RTK-së paguhen edhe bileta edhe udhëtimi, varësisht prej marrëveshjes me delegacionet që shoqërojmë.

Për shkak të gjendjes financiare në muajin e fundit jam munduar ta ndërpre udhëtimet, përveç atyre që janë të domosdoshme. Ndërkaq sa i përket brenda Kosovës, në Gjakovë kemi, mirëpo nëse ka ngjarje më shumë, sigurisht që shkojnë edhe ekipet prej Prishtinës. Në Gjilan gjithashtu kemi pasur korrespondentë deri para dy tre muajve, poashtu edhe në Mitrovicë kemi pasur korrespondentë një kohë të gjatë që e kemi shfrytëzuar më shumë për Radio. Kemi planifikuar të kemi korrespondentë edhe në qytete të tjera në mënyrë që të mbulohet një rajon, por për shkak të buxhetit për momentin nuk planifikojmë ta rrisim sidomos këtë vit.

Tek borxhet sigurisht është një problem që RTK-ja ballafaqohet prej vitit 2013. Kemi goxha probleme sidomos tek përmbaruesit të cilët gjatë këtij viti kanë marrë diku 400 mijë euro. Unë jam munduar ti takoj edhe borxhlinjtë në mënyrë që të bëjë marrëveshje, kryesisht borxhlinjtë e vegjël sepse kemi edhe borxhlinj të mëdhenj prej vitit 2013, p.sh institucion publik është edhe KTMN ku ne i kemi borxh gjysmë milioni, por jemi edhe aksionarë aty. Ne kemi punë ende aty për shkak të procesit të digjitalizimit, nuk kemi mundur të zgjidhim këtë problem ende.

Arbërie Nagavci: A jeni ju borxhlinj të tyre apo ata borxhlinj të juaj?

Ngadhënjim Kastrati: është e dyanshme sepse ne jemi aksionarë, përveç që jemi aksionarë ata duhet të paguajnë edhe për antena sepse ata janë përgjegjës për antena. Kështu ne e bëjmë një lloj barazie. Borxh tjetër që rregullohet është edhe Telekom i Kosovës. Ne nuk kemi pasur me Telekomin marrëveshje që ne me shfrytëzu telefonin e tyre ata marketingun. Ne kemi marrë shërbimet e tyre me para kesh dhe ata marketingun e kanë bërë kesh dhe ata na kanë borxh deri 80.000 euro. Tek emisionet për shkak të buxhetit janë ndërpre zakonisht në fund të qershorit. Ne jemi marrë vesh të i ndërprejmë ato në qershor dhe nëse jemi në gjendje të keqe nuk mund të vazhdojmë.

Adelina Hyseni - Valla: Borxhi i RTK-së për vitin e kaluar është 3 milionë e 892 mijë euro. Për emisionet e jashtme, ato paguhen për emisionet që bëjnë. Emisioni i Natës shembull e ka pasur personi i caktuar dhe është paguar, nuk ka pasur rrogë tjetër.

Kryetari: Pasi jeni në borxh atëherë ju nuk keni nevojë të shpenzoni 20%-shin, bashkëpunimet e jashtme janë 500 mijë euro. Nëse i kursejmë 500 mijë euro në vit dhe korrespondenca prej 500 mijë euro tjera, atëherë do paguhet borxhi prej 2013 dhe stabilizohet RTK-ja. Në anën tjetër nëse vazhdoni me rrit numrin e punëtorëve atëherë nuk do të ketë ndryshime. Më intereson të di a është numër i lartë 881 punëtorë, sa i ka një radio televizion rajonal?

Ngadhënjim Kastrati: RTK-ja ka 4 kanale, p.sh RTK 2 ka rreth 200 punëtorë, nuk është numri i madh prej viti në vit që punojnë në radio. Tek punësimet me shërbime lidhim kontrata me përkthyes p.sh deri 20 kontrata që ndodhin gjatë vitit të paguhet deri në 50 euro për një përkthim, edhe nëse ka kontratë. Seriali “Çka ka shpija”, figuron në listën e punëtorëve me shërbime dhe atij i ndërpritet dhe RTK-ja mundet me ia ndërpre nëse nuk ka buxhet edhe pse kanë kontratë para një 1 viti ose 2.

Arbërie Nagavci: Keni marrë vendim me i ndërpre këto kontrata, detajisht ju theksoni se disa do të ndërprehen e disa jo, a mund të tregoni cilat prej tyre dhe çfarë kriteresh keni vendosur?

Ngadhënjim Kastrati: Gjitha emisionet që janë produkte të jashtme janë ndërpre, ndodh ndonjë që nuk e ka plotësuar numrin p.sh gjatë muajit maj sipas numrit të kontratave është dashur të mbërrijë numrin. Emisionet me të punësuar të brendshëm nuk janë ndërpre, ndërsa emisionet e jashtme që paguhen prej RTK-së janë ndërpre. Faturë në muajin qershor nuk sjell askush.

Kryetari: Nëqoftëse është një emision i jashtëm dhe ka një kohë të caktuar, marketingu a i shkon emisionit apo juve?

Ngadhënjim Kastrati: Varësisht prej kontratave, p.sh Çka Ka Shpija, marketingu shkon për ne, por ka edhe seriale me të cilat lidhet kontrata për shfrytëzim marketingu nga realizuesi i emisionit.

Ali Lajçi: Për borxhet e mbetura gjatë planifikimeve, a keni ndonjë datë të caktuar kur do të paguhen?

Afërdita Maliqi: Ne si bord kemi marrë vendim për t'i ndërprerë shumicën e programeve, kontratave dhe shërbimeve të jashtme dhe drejtori aktual po i zbaton vendimet. Tek çështja e borxheve kemi kërkuar me projektin në shlyerjen e borxhit. Nga menaxhmenti thuhet se në projeksionin buxhetor nuk kemi mundësi apo edhe të drejtë në shlyerjen e borxheve me buxhetin e planifikuar.

Adelina Hyseni-Valla: Sa i përket çështjes së borxhit shifra nuk është krijuar nga formimi i RTK-së por shuma 12 milionë e 700 mijë përfshin vitin 2013. Kur është zvogëluar buxheti i RTK-së nga Kuvendi, kemi mbetur në borxhe sepse janë kontraktuar shpenzime me palë.

Kryetari: Në fillim të vitit keni theksuar se do shpenzohen 61 mijë euro naftë dhe keni realizuar saktë të njëjtën shifër. Pos naftës si e keni ditur se do shpenzohen 270 mijë euro në udhëtime zyrtare jashtë vendit?

Afërdita Maliqi: Kjo çështje që edhe ne e kemi diskutuar, RTK-ja ka specifikacione, kemi të bëjmë me një llogaritje përafërsisht të planifikimit në këtë medium.

Kryetari: Saktë e keni gjetur brenda 12 muajve se sa do të riparohen makina në shumë prej 40.000 euro këtë vit. Ose mbi përkthimet saktësisht, shpenzime prej 55 mijë euro. A keni planifikim, nëse po është e pamundur të janë shifrat qindpërqind.

Naser Osmani: Menaxhmenti duhet të bëjë një planifikim financiar të buxhetit. Borxhet duhet shlyen nga RTK.

Arbërie Nagavci: Pyetja që nuk mora përgjigje është rreth 25 mijë euro për shpenzimet operacionale për bordin, a mund të na sqaroni rreth këtyre shpenzimeve sepse është dyfishim për udhëtimet zyrtare nga viti paraprak.

Afërdita Maliqi: Shpenzimet janë më të larta për bordin pasi që vitin e kaluar kemi punuar për draftligjin e RTK-së ku ka pasur komisione parlamentare për media, punëtori, tre udhëtime bashkë me komisionet për media etj.

Kryetari: është dashur të bëhet një planifikim afatmesëm 3-5 vjeçar financiar dhe të shlyerjes së borxhit. Në kategori të trasha sa do jenë të hyrat dhe shpenzimet për vitet e ardhshme? Në aspektin financiar besoj se deri në tetor duhet të keni planifikim të mirëfilltë financiar. Kështu do të trajtojmë buxhetin e RTK-së në vite. Për vitin paraprak do kërkojmë nga auditori, auditim të përgjithshëm ngase është para publike dhe nuk keni arsye për kundërshtim të një auditimi të tillë.

Sa i përket planit për shlyerjen e borxheve brenda tre viteve, një plan i tillë nuk nënkupton para shtesë nga Kuvendi. Në bazë të planifikime që do të mund të bëni, tregoni se cilat shkurtime do të bëni dhe në bazë të atij plani do të dihen sa shpenzime apo kursime të buxhetit do të mund të arrini që të mund pastaj të shlyeni borxhet.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të votimit, Kryetari konstatoi se Komisioni shtyu votimin e Raportit vjetor financiar të RTK-së për vitin 2018, deri në pranimin në Kuvend të Raportit të Auditimit të Zyrës Kombëtare e Auditimit për pasqyrat financiare të RTK-së.

9. Diskutim në lidhje me Kërkesën nr. 590, dt. 16.04.2019 e KOSTT, lidhur me çështjen e pagave

Kryetari: ia kalojë fjalën Drejtorit të KOSTT-it, z. Ilir Shala për të informuar Komisionin lidhur me çështjen e pagave të stafit të KOSTT-it.

Ilir Shala: Ne kemi bërë një përmbledhje në disa pika në aspektin kushtetues, ligjor dhe rregullativ të KOSTT-it. Aspektin operativ, investimet kapitale dhe konstatimet kanë qenë të prezantuara në Kuvend. Miratimi i ligjit për paga kemi parë se ka ndikim ligjor, rregullativ dhe kushtetues në institucionin tonë. KOSTT është një ndërmarrje publike që nuk financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Pra ligjërisht është e pavarur dhe ka në pronësi asetet të gjitha resurset teknike ligjore dhe financiare. Meqenëse fokusi është tek ligji i pagave dhe sipas asaj si është paraparë me këtë ligj, 53% do ketë zvogëlim të pagave dhe atëherë do të ketë dëmtim edhe të të hyrave për stafin edhe ikje masive nga ndërmarrja, duke pasur parasysh se KOSTT ka stafin më profesional. Këtë e kanë argumentuar edhe organet tjera ndërkombëtare.

Kryetari: A lejoni hapësirë që ligji për paga në ndërmarrjet publike që nuk financohen nga buxheti të bëjnë kompensime në forma tjera?

Visar Hoxha: Ligji i pagave i ka kufizuar shtesat dhe kategoritë me të cilat merret stafi inxhinierik sipas përkufizimeve të ligjit. Në atë kategori hynë stafi depozitar që ka qenë kryesisht IT, por edhe ato shtesa janë minimale dhe nuk e kompensojnë zvogëlimin që do të ndodh.

Arbërie Nagavci: Rastet e ngjashme të ankesave të këtij projektligji ka pasur edhe me herët. A e keni paraqitur këtë shqetësim edhe tek Qeveria sepse proceduralisht pa amandamentim të ligjit nuk bëhet diçka konkrete me përjashtim që të mos e vlerësojmë këtë çështje edhe me inicju. Komisioni për Arsim,

shembull kemi inicu amandamentimin për kategori të caktuara të mësimdhënësve. Pra kemi adresuar tek Qeveria sepse janë disa kategori që kanë shqetësime me këtë ligj.

Ali Lajçi: çfarë ka ndodhur me trajtimin dhe qasjen ndaj pagave për bordin që kemi konsideruar se i janë marrë të jashtëligjshme?

Ilir Shala: Lidhur me këtë çështje lënda është dërguar në Agjensionin Kundër Korrupsion që pastaj është dërguar në prokurori, tash si zhvillohet situata nuk e di.

Mërgim Lushtaku: Me rastin e shqyrtimit të ligjit pagave, kam ngritur shqetësimin se për disa ndërmarrje që janë të rëndësishme siç është rasti i KOSTT-it, dhe disa të tjera, të kemi kujdes në çështjen e pagave sepse pastaj mund ti bëjmë dëme me ikjen e mundshme të stafit profesional. Duhet të diskutohet edhe mes komisionit sepse duhet të bëhet analiza e mirëfilltë se çfarë dëmi bëhet me ndërhyrjen në paga në ndërmarrjet publike.

Ilir Shala: Kemi zhvilluar takime me të gjitha komisionet si me atë për Zhvillim Ekonomik, Buxhet dhe Financa, Funkcional që ka shqyrtuar projektligjin për paga. Komisioni për Zhvillim Ekonomik ka pranuar takim, sipas informatave të fundit ata do rekomandojnë që KOSTT të largohet prej ligjit për paga. Do ta sensibilizojmë këtë çështje edhe në qeveri. Ne kemi një staf profesional që duhet ruajtur sepse është në interes të institucionit.

Kryetari: A pajtoheni me rastin e ngritjes së koeficientit brenda ligjit apo kërkoni heqjen nga ligji aktual?

Ilir Shala: Nuk është puna vetëm si dëshirë e stafit por është e rregulluar me ligj dhe Kushtetutë që KOSTT nuk do të jetë brenda kornizës ligjore të ligjit të pagave.

Kryetari: Meqë komision funksional për KOSTT-in është Komisioni për zhvillim ekonomik, çështja në fjalë duhet adresuar përmes atij komisioni.

10. Shqyrtimi i Kërkesës nr.00255/19/shs, dt. 11 mars 2019 së Drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e lartësisë së koeficientit dhe të pagës së Drejtorit dhe Zëvendës-Drejtorit të kësaj Agjencie

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që pikën 10 ta shtyjë për shqyrtim për mbledhjen e radhës.

11. Të ndryshme

Në të ndryshme nuk pata ndonjë çështje për diskutim.

**Mbledhja përfundoi në orën 13:30
Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit**

Kryetari i Komisionit,

Lumir Abdixhiku